



Pranuar / Doretuar Priljevoj/Prilato Received/Delivery	02.06	2021	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHUK	2799	2021	114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.292/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj–Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.292/2021, të datës 21.04.2021, të parashtruar nga me adresë banimi Rr“ Astrit Rrushi” Kompleksi Relax 4, H1-K6, Nr.17, Prishtinë, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike“ *Kompensim material* ”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.292/2021 e datës 21.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 21.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1916/2021 të regjistruar me A.nr.292/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shujtës ditore, pagës së trembëdhjetë për vitin 2018, 2019 dhe 2020 dhe pagës jubilarë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ndërsa me datë 30.04.2021 përmes e-maili ka bërë plotësimin e ankesës e regjistruar me numër protokoll: 2148/2021 me pretendimin për pagesën e shtesave për kualifikimin shkollor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.04.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Policia e Kosovës. Ndërsa me datë 07.05.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, për vendosje në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.04.2021, e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 1916/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin e Punësimit të datës 15.04.2021; E-maili i datës 14.04.2021 i dërguar nga _____ për _____ me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2020; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2018; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2019; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 23.04.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 11.05.2021; Kontratën e punës së ankuesit të datës 25.09.2009 me numër reference: 07/1-01A/0074; Përshkrimin e detyrave për pozitën Auditor i Brendshëm në Policinë e Kosovës; E-mailin e datës 14.04.2021 dërguar nga _____ për _____ dhe të tjerët; E-mailin e datës 22.04.2021 dërguar nga _____ për _____

Lista e pagës për ankuesin për muajin korrik 2015; Procesverbalin për ankesa të datës 12.05.2021 me numër prot: 2365/2021; Plotësimin e ankesës i datës 30.04.2021; E-mailin e dërguar nga ankuesi me datë 30.04.2021 për plotësimin e ankesës të datës 21.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se ankesa e ankueses _____ është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Kontratën e Punës të datës 25.09.2009, është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Auditor i Brendshëm" në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ndërsa sipas vërtetimit të datës 15.04.2021 ankuesi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës e ka themeluar me datë 24.01.2005.

Drejtoria e Personelit pranë Policisë së Kosovës, përmes përgjigjes me shkrim dërguar nëpërmjet e-mailit të datës 14.04.2021 ka njoftuar stafin e Policisë se nuk është kompetent për të vendosur lidhur me kërkesat e tyre për shtesa në pagë siç përcaktohen në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Pas kësaj përgjigje ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i njeh të drejtën e kompensimit të shujtës ditore, pagës së trembëdhjetë për vitin 2018, 2019 dhe 2020, pagës jubilarë dhe shtesave për kualifikimin shkollor sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i zbatueshëm Ligji për Shërbimin Civil, stafi civil në Policinë e Kosovës, i është nënshtruar përveç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave të ligjit të veçantë, gjegjësisht Ligjit për Policinë e Kosovës.

Andaj, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, përkatësisht nenin 47 të këtij ligji ku përcaktohet se: ... 2.Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe beneficione..., 3.Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërrime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Beneficionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për

transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe beneficionet e pensionit; 4. Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se neni 47 i Ligjit për Policinë e Kosovës, rregullon shtesat, kompensimet dhe beneficionet përtej pagës themelore vetëm për zyrtaret policor, gjegjësisht vetëm për kategorinë e personelit policor të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e shtesave dhe kompensimeve përtej pagës themelore, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, duke u thirrur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, konsiderohen të pa qëndrueshme sepse nuk kanë bazë në Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke marr parasysh konstatimin se ligji i veçantë nuk ka rregulluar çështjen e shtesave dhe kompensimeve tjera përtej pagës bazë për stafin civil të Policisë së Kosovës, vlerëson se për këtë kategori të të punësuarve në Policinë e Kosovës, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me datë 09.07.2020 ka nxjerr Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti në pikën 211 ka përcaktuar se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon funksionet dhe organizativitetin të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të, andaj, bazuar në këtë dhe duke iu referuar nenit 2 paragrafi 3 dhe nenin 19 të këtij ligji, Kolegji konstaton se stafi civil në Policinë e Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara vetëm sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit të aplikueshëm për pagat e nëpunësve civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr. 292/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

